

Ky raport i monitorimit të aktiviteteve të prokurimit përshin 10 tenderë në pesë komuna, atë të Shtimes, Podujevës, Kamenicës, Obiliqit dhe Fushë Kosovës. Për secilën komunë janë monitoruar nga dy tenderë, duke filluar nga inicimi i aktivitetit të prokurimit e deri në zbatimin e kontratës. Nga ky monitorim, D+ ka identifikuar disa gjetje të cilat janë të përbashkëta për këto pesë komuna, por gjithashtu janë evidentuar edhe shkelje të cilat janë karakteristike e vetëm një komune. Disa prej gjetjeve kryesore të këtij raporti përfshijnë:

- Mosplanifikimi i saktë i vlerës së parashikuar të tenderit, ku komuna e Kamenicës ka paguar çmim shumë të lartë për një metër kub dru, krahasuar me kontratën e vitit paraparak dhe atë të Komunës së Obiliqit. Si pasojë e vlerës së parashikuar që ishte shumë e lartë, komuna u ka mundësuar operatorëve ekonomikë të ofertojnë me çmime të larta, e rrjedhimisht edhe çmimi në kontratë është i lartë. Komuna e Fushë Kosovës gjithashtu nuk ka parashikuar saktë se sa kushton në treg një Golf VI i përdorur. E njëjta, për një veturë të tillë, e cila në treg kushton prej 9,000 deri në 10,000 euro, ka paguar 12,975 euro.
- Dallimet ndërmjet titullit të tenderit dhe punëve të parapara në paramasë. Një tender i komunës së Shtimes ka titullin “Riparimi i urave dhe shtratit të lumit”, megjithatë para masa përmban vetëm elemente për rregullimin e urave.
- Sa i përket specifikave teknike të produkteve të kontraktuara, nuk përputhen me ato që kërkohen në dosje të tenderit. Në komunën e Shtimes janë kërkuar kamera që incizojnë video dhe audio, megjithatë kamerat që janë montuar mund të incizojnë vetëm video.
- Problemet në llogaritje të shpenzimeve për tenderët e sigurimit fizik. Komuna e Obiliqit nuk ka kalkuluar siç duhet shpenzimet që do të kishte një operator ekonomik për të gjitha obligimet që dalin nga Ligji i Punës siç janë pagesat për kontributin pensional, orët shtesë, pushimin vjetor, etj. Si rezultat, komuna ka lidhur kontratë me të cilin çmim nuk i mbulon të gjitha shpenzimet.
- Kërkesat e paqarta në kriteret e dosjes së tenderit. Në disa komuna ka kritere që janë të paqarta dhe nuk janë të definuara saktë. Këtu përfshihen kërkesat për mjete të transportit pa specifikuar peshën e tyre, kërkesa për hapësirë të ruajtjes së druve pa specifikuar sipërfaqen e saj etj.